



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



## Shënimi i ditës botërore të shëndetit mendor



Foto: disa nga anëtarët e Klubit Dëshira gjatë panairit të punës në Prishtinë. Lumnije Demolli e treta me rradhë nga e majta

Lumnije Demolli është 37 vjeçare dhe vuan nga sëmundja e shëndetit mendor. Lumnija për më shumë se 26 vite ka qenë e izoluar në shtëpi. Ajo nuk ka shkuar as në shkollë, dhe nuk ka ditur as shkrim-lexim. Kjo për shkak të mos përkrahjes nga ana e familjes si dhe ofendimit dhe fyerjes nga fqinjët dhe fëmijët e lagjes. “Unë kom ardhë këtu bashkë me babin tem. Kom jetu me babin gjyshen edhe gjyshen. Te tret më kanë vdekë. Tash unë vazhdoj me ardhë në Klubin Dëshira. Jam shumë e gëzushme se këtu kom mësu shkrim lexim dhe tash po mësoj rrobaqepsi dhe kam fillu me punu si ndihmse e rrobaqepses. Tash përmes Klubit Dëshira, shoqërohem me studenta, me njerëz. Përpara më thojshin ti je budallic, nuk mujsha as me dalë jashtë, nuk më lejshin. Tash jam shumë e lumtur që vi këtu edhe me shoqëri e kalojmë mirë”.

Organizata joqeveritare Klubi Dëshira nga Prishtina është një qendër ditore për rehabilitimin e personave me probleme në sferën e shëndetit mendor me rreth 200 anëtarë. Pjesëmarrja aktive e anëtarëve kontribon në

identifikimin dhe referimin e personave të tjerë me probleme në sferën e shëndetit mendor, të marginalizuar nga shoqëria dhe të izoluar nga familjarët. Për shumë persona me dëmtime mendore në Kosovë, liria e lëvizjes është mjaft e vështirë dhe kjo kategori është e “izoluar” edhe nga vetë anëtarët e familjes së tyre, për shkak të paragjytimeve që vijnë nga shoqëria.

Klubi Dëshira po zhvillon programe integruese, edukative dhe sociale, duke përfshirë kurse rreth përdorimit të kompjuterit, shkrim-leximit, ofrimit të shërbimeve mbështetëse dhe këshilluese për punë, etj, për anëtarët me dëmtime të shëndetit mendor. Fokusi është që anëtarët përveç socializimit dhe rehabilitimit, të bëhen më të pavarur, ku përmes trajnimeve për punësim dhe vetëpunësim të angazhohen dhe integrohen në tregun e punës.

Sot, Klubi Dëshira shënon Ditën Botërore për shëndetin mendor përmes një fushatë avokuese për të drejtat e personave me dëmtime mendore, duke kontribuar në rritjen e vetëdijes së publikut për nevojat e kësaj kategorie dhe duke u angazhuar drejt një bashëpunimi më konstruktiv ndërmjet institucioneve Kosovare dhe kësaj iniciative.

*Klubi Dëshira po implementon projektin “Zgjerimi i pjesëmarrjes së personave me dëmtime intelektuale në punësim dhe vetëpunësim” që mbështetet në kuadër të programit Angazhimi për Barazi - E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.*